



Planuar / Dorezuar Primi/Prodato Received/Delivered	18 - 08 2023	3	viti god. year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKUPSHOCK	5712/2023		1/6



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.898/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare dhe Arben Mehmeti-dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.898/2022 të datës 30.06.2023, e parashtruar nga ankuesi _____, me adresë: _____

_____ kundër organit të punësimit Komunës së Kamenicës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 18.08.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër Anr.898/2023 e datës 30.06.2023, e parashtruar nga ankuesi _____
- II. Anulohet konkursi i datës 21.03.2023 sipas numrit të referencës RN0004888 për emrin e grupit *Specialistë i Biologjisë dhe Botanikës* për pozitën *"Zyrtar për Prodhimtari Bimore"* në Drejtorinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, i shpallur nga Komuna e Kamenicës si dhe shfuqizohen të gjitha vendimet që rrjedhin nga kjo procedurë e rekrutimit.
- III. Obligohet Udhëheqësi i Personelit të Komunës së Kamenicës, që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore, me qëllim të zbatimit të këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Komuna e Kamenicës duke u bazuar në dispozitat e nenit 34 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 7 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, me njoftimin e datës 21.03.2023 ka shpallur konkursin e jashtëm për pranim me numër reference RN000011250, për grupin "Specialist i Biologjisë dhe Botanikës", për pozitën "Zyrtar për Prodhimtari Bimore", me afat aplikimi nga data 11.04.2023 deri me datë 18.04.2023, në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi [REDAKTUAR] ku edhe ka qenë i përfshirë në të gjitha fazat e vlerësimit, deri në njoftimin e datës 07.06.2023 lidhur me rezultatet përfundimtare, duke arritur gjithsejtë shtatëdhjetë e dy pikë (72), dhe me ç' rast është renditur i dyti në listë.

Tutje i pa kënaqur me rezultatin përfundimtar sipas njoftimit të datës 07.06.2023, ankuesi me datë 09.06.2023 ka parashtruar ankesë tek Komisioni për Pranim në Komunën e Kamenicës, me pretendimet ankimore se procedurat e vlerësimit të testimit me shkrim dhe vlerësimi i jetëshkrimit janë zhvilluar në kundërshtim me Rregulloren për Pranim dhe Karrierë në Shërbimin Civil, pasi që i njëjti nuk është vlerësuar meritorisht. Ndërsa me vendimin e datës 16.06.2023, ankuesit i është refuzuar ankesa si e pa bazuar, me arsyetimin se testimi me shkrim është zhvilluar në mënyrë elektronike dhe gjithashtu vlerësimi i jetëshkrimit është bërë me korrektësinë më të lartë nga Komisioni i Pranimin për konkursin e jashtëm për pranim me numër reference RN000011250, për grupin "Specialist i Biologjisë dhe Botanikës", për pozitën "Zyrtar për Prodhimtari Bimore".

Ankuesi i pa kënaqur me vendimin e datës 16.06.2023 të Komisionit të Pranimin pranë Komunës së Kamenicës, me datë 30.06.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për anulimin e konkursit në fjalë sepse procedurat e vlerësimit të testimit me shkrim dhe vlerësimi i jetë shkimit janë zhvilluar në kundërshtim me rregulloret dhe ligjet në fuqi për Pranim dhe Karrierë në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, pasi që i njëjti nuk është vlerësuar meritorisht dhe si i tillë nuk është shpallur kandidat fitues.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 06.07.2023, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Kamenicës, ndërsa Këshilli me datë 11.07.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Komuna e Kamenicës.

Me Vendimin me numër të protokollit 5619/2023 të datës 11.08.2023, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka vazhduar afatin për vendosje të ankesës me numër A.nr.898/2023 të datës 30.06.2023 edhe dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 4980/2023 të datës 30.06.2023 të parashtruar nga ankuesi M.D në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën e datës 09.06.2023 të parashtruar nga

ankuesi M.D në Komisionin e Pranimi për Konkursin me emër grupi Specialist të Biologjisë dhe Botanikës, me numër reference RN00011250; Kontratën e punës dhe detyrat specifike të lidhur mes "Arbor Grup SH.P.K" dhe M.D; Diplomën me numër 553 të datës 02.09.2016 të lëshuar nga Universiteti I Prishtinës "Hasan Prishtina"-Fakulteti I Bujqësisë dhe Veterinarisë për M.D; Kopjen e Letërnjoftimi të M.D; Diplomën me numër 367 të datës 14.10.2021 të lëshuar nga Universiteti I Prishtinës "Hasan Prishtina"- Master në Mbrojtjen e Bimëve për M.D; Vërtetimin e datës 12.04.2023 të lëshuar nga Sistemi Qendror I Evidencës Penale të Kosovës për M.D; Vërtetimin e datës 12.04.2023 të lëshuar nga Policia e Kosovës për M.D; Vërtetimin me numër protokoll 10818 të datës 16.04.2021 të lëshuar nga Komuna e Kamenicës për M.D; Letër reference të datës 18.04.2023 të lëshuar nga "Geo-Land" Sh.P.K për M.D; Referencë e datës 02.11.2016 të lëshuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës për M.D; Vendimin e datës 16.06.2023 të lëshuar nga Komisioni I Pranimi pranë Komunës së Kamenicës për M.D; Lista e kandidatëve të aprovuar me numër 27 të datës 12.05.2023 e lëshuar nga Komuna e Kamenicës; Njoftimin e datës 07.06.2023 të lëshuar nga Komuna e Kamenicës; Diplomën me numër protokoll 358 të datës 02.06.2007 të lëshuar nga Sh.M "Ismail Qemali" për M.D; Njoftimin për shpalljen e konkursit me emër grupi Specialist I Biologjisë dhe Botanikës me numër reference RN00011250 të datës 21.03.2023 të Komunës së Kamenicës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 06.07.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës drejtuar Komunës së Kamenicës; Përgjigjen në ankesë me numër protokoll 8981 të datës 11.07.2023 të Komunës së Kamenicës për Këshillin e Pavarur e Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër 33 të datës 16.05.2023 të Kryetari të Komunës së Kamenicës; Listën e verifikimit paraprak të kandidatëve me numër 27 të datës 12.05.2023 të Komunës së Kamenicës; Njoftimin për rezultatet përfundimtare të datës 07.06.2023 të Komunës së Kamenicës; Listën e aplikantëve për Konkursin me numër Reference RN00011250 të SIMBNJ; Renditjen përfundimtare të kandidatëve për konkursin me emër grupi Specialist I Biologjisë dhe Botanikës për konkursin me numër reference RN00011250; Aplikacioni I kandidatit M.D I datës 18.04.2023 së bashku me përgatitjen profesionale dhe atë të përvojës së punës; Certifikatën me numër 476 të datës 20.12.2019 të lëshuar nga Qendra Edukuese e Fermerëve për M.D; Certifikatën e datës 30.03.2013 të lëshuar nga "USAIDI" për M.D; Kontratën për punë dhe detyra specifike me numër protokoll 27105 të datës 08.09.2021 të lidhur në mes Komunës së Kamenicës dhe M.D; Aplikacionin e kandidatës K.K të datës 12.04.2023 së bashku me përgatitjen profesionale dhe atë të përvojës së punës; Vërtetimin e kopjes së dokumenteve nga origjinali me Nr.Rendor.LRP.7307/2019; Diplomën me numër 1546 të datës 23.12.2021 të lëshuar nga Universiteti I Prishtinës "Hasan Prishtina"-Fakulteti I Bujqësisë dhe Veterinarisë për K.K; Certifikatën e lëshuar Komuna e Gjilanit për K.K; Certifikatën e lëshuar nga Komuna e Gjilanit për K.K; Certifikatën e datës 02.11.2019 të lëshuar nga "General Youth Education of Kosovo" për K.K; Certifikatën me numër 520 të datës 20.12.2019 të lëshuar nga Qendra Edukuese e Fermerëve për K.K; Kontratën për punë dhe detyra specifike me numër protokoll 16047 të datës 04.08.2020 të lidhur në mes Komunës së Kamenicës dhe K.K; Referencë e datës 06.04.2023 e lëshuar nga DBPZHR; Kopjen e letërnjoftimit të K.K; Certifikatën e datës 03.04.2023 të lëshuar nga Sistemi Qendror I Evidencës Penale të Kosovës për K.K; E-mailin e datës 02.08.2023 të Komunës së Kamenicës për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Listën e kandidatëve me poentimet; Rezultatin e vlerësimit të kandidatit M.D nga të gjithë anëtarët e komisionit, E-mailin e datës 02.08.2023 të Komunës së Kamenicës për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Rezultatin e vlerësimit të

kandidates K.K nga të gjithë anëtarët e komisionit; Vendimi me numër të protokollit 5619/2023 i datës 11.08.2023, i Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar së pretendimet ankimore të ankuesit [redacted] janë të bazuara, sepse:

Pasi i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit si dhe të gjitha provat e lëndës Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se kriteret e konkursit të shpallur nga Komuna e Kamenicës për emrin e grupit *Specialist i Biologjisë dhe Botanikës* me numër reference RN00011250 për pozitën *"Zyrtar për Prodhimtari Bimore"* në Drejtorinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, për klasën e pozitës Profesional 2, kanë qenë si në vijim:

- *Diplomë e arsimit të lartë më së paku tre (3) vite të studimeve. Fakulteti i Bujqësisë drejtimi Botanikë, Prodhim Bimor, Agronomi, Biologji;*
- *Kualifikime të Posaçme formale: Certifikata licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitat e kësaj klase;*
- *Përvoja e punës e kërkuar: Së paku një (1) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.*

Ne baze të shkresave të lëndës Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se në konkursin me numër referencë RN00011250, për emrin e grupit *"Specialist i Biologjisë dhe Botanikës"* për pozitën *"Zyrtar për Prodhimtari Bimore"*, të shpallur nga Komuna e Kamenicës sipas njoftimit datës 21.03.2023 për afat aplikimi nga data 11.04.2023 deri me datë 18.04.2023, ka aplikuar edhe ankuesi ku ka qenë i përfshirë në të gjitha fazat e konkurrimit, andaj ankesën ankuesi e ka parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pas njoftimit të mos përzgjedhjes së tij si kandidatit fitues për pozitën e lirë dhe refuzimit të ankesës së tij nga Komisioni i Pranimit, me pretendimet ankimore për anulimin e konkursit në fjalë sepse procedurat e vlerësimit të testimit me shkrim dhe vlerësimi i jetëshkrimit janë zhvilluar në kundërshtim me rregulloret dhe ligjet në fuqi për Pranim dhe Karrierë në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, pasi që i njëjti nuk është vlerësuar në mënyrë të drejtë në testimin me shkrim dhe respektivisht në fazën e vlerësimit të jetëshkrimit nuk është vlerësuar me pikë maksimale pasi që posedon Diplomën Bachelor dhe gjithashtu Diplomën Master me notë mesatare tetë pikë nëntëmbëdhjetë (8.19).

Kolegji nga analizimi i dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve të përfshirë në listën e ngushtë, ka gjetur se njësia përgjegjëse nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike sepse bazuar në shkresat e lëndës gjegjësisht sipas dëshmive të dorëzuara nga kandidatët me rastin e aplikimit, është konstatuar se kandidatja e përzgjedhur [redacted] në këtë rast si njëra ndër kandidatet fituese për pozitën e punës *"Zyrtare për Prodhimtari Bimore"*, lidhur me përvojën e punës ka prezantuar Kontratën për punë dhe detyra specifike të datës 04.08.2020 të lëshuar nga Kryetari i Komunës së Kamenicës me kohëzgjatje prej 3 muaj, Referencën e datës 06.04.2023 të lëshuar nga Drejtori në DBPZHR në Komunën e Kamenicës sipas së cilës theksohet se e kandidatja në fjalë ka qenë në marrëdhënie të punës në pozitën Zyrtare për Grante dhe

/Subvencione pranë sektorit të Bujqësisë në Komunën e Kamenicës për periudhën Prill-2020 deri në Shkurt-2021, ndërsa sa i përket vlerësimit të kualifikimit kandidatja e përzgjedhur posedon Diplomë me numër 1546 të datës 23.12.2021, të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Hasan Prishtina " me të cilën dëshmohet se ka përfunduar Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë në programin Prodhimtari Bimore me date 23.12.2021 dhe ka marrë titullin Bachelor në Prodhimtari, rrjedhimisht në bazë të të gjitha dëshmive të ofruara nga organi i punësimit, për përgatitjen profesionale dhe përvojën e punës për kandidaten e përzgjedhur, Kolegji ka konstatuar, se kandidatja e përzgjedhur nuk ka arritur të dëshmojë përvojën e punës prej 1(një) viti përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës", ashtu siç është kërkuar me konkurs respektivisht kandidatja e përzgjedhur nuk i ka plotësuar kriteret e konkursit sepse deri në momentin e përgatitjes së listës së shkurtër nuk e ka përvojën e punës prej 1(një) viti pas diplomimit, çka nënkupton se e gjithë përvoja e punës në rastin konkret duhet të jetë e fituar pas shkollimit universitar ndërsa kandidatja e përzgjedhur ka ofruar dëshmi lidhur me përvojën e punës vetëm para diplomimit.

Andaj sa i përket vlerësimit të përvojës së punës pas diplomimit, Këshilli i është referuar Aktgjykimit A.nr.2276/2014 të datës 24.05.2016 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Aktgjykimit A.nr.729/16 të datës 04.05.2018 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Aktgjykimit AA.nr.367/1819.12.2018 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative dhe Aktgjykimit ARJ-UZVP.nr.77/2019 të Gjykatës Supreme të Kosovës, ku përmes këtyre aktgjykimëve konstatohet se për pozitën profesionale, përvoja e punës së kërkuar duhet të jetë pas diplomimit,

Andaj nisur nga ky fakt Kolegji konstaton se kandidatja e përzgjedhur [redacted] nuk i ka plotësuar kushtet e konkursit sa i përket përvojës së punës prej një (1) vit ashtu siç është kërkuar me konkurs dhe me këtë rast Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Prizrenit me rastin e përfshirjes së kandidatës [redacted] në listën e ngushtë ka vepruar në kundërshtim me nenin 15 paragrafin 1, 2, dhe 3 si dhe nenin 56 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 57 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 Për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe me rastin e përzgjedhjes të së njëjtës si kandidatë fituese Komisioni i Pranimit i Komunës së Kamenicës ka vepruar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Andaj, Kolegji i Këshillit, pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë si dhe analizimit të dispozitave ligjore lidhur me kushtet dhe kriteret e pranimit në shërbimin civil, duke marrë për bazë edhe konstatimet e pasqyruara si në arsyetimin e këtij vendimi, ka konstatuar se konkursi i shpallur me datën 21.03.2023 me numër reference RN000011250, për grupin "Specialist i Biologjisë dhe Botanikës", për pozitën "Zyrtar për Prodhimtari Bimore", në Drejtorinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, për klasën e pozitës Profesionale 2 në Komunën e Kamenicës është bërë në kundërshtim me nenin 4 paragrafin 2 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe në kundërshtim me nenin 6 paragrafin 1 dhe 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe mbi këtë bazë edhe ka vendosur t'a anulojë konkursin e lartë cekur si dhe të shfuqizojë çdo akt tjetër administrativ që rrjedh nga kjo procedurë e rekrutimit, kurse ankesa e ankuesit është aprovuar mbi bazën e kësaj të gjeture.



Nisur nga konstatimet si më lartë, Kolegji duke u bazuar ne Nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, konstaton se një procedurë rekrutimi e përfshirë më shkelje të dispozitave materiale konsiderohet procedurë e paligjshme, kështu që me qëllim të vendosjes së ligjshmërisë, Kolegji në mbështetje të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.898/2023.

Ilire Mehmeti-SHAQIRI


Procesmbajtëse

Malsore GASHI BAJRAKTARI


Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Kamenicës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Kamenicës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;